



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 57

2002

Shtator

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 54, datë 5.9.2002	Për disa ndryshime në përbërjen e delegacioneve të përhershme të Kuvendit.....	1627
Vendim i Kuvendit nr. 55, datë 5.9.2002	Për disa ndryshime në komisionet e përhershme të Kuvendit.....	1628
Vendim i Kuvendit nr. 56, datë 5.9.2002	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr.36, datë 16.5.2002 «Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE- së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001”, i ndryshuar.....	1629
Vendim i Kuvendit nr. 57, datë 5.9.2002	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 37, datë 16.5.2002 “Për krijimin e Komisionit të Integritetit European dhe Paktit të Stabilitetit”, i ndryshuar.....	1629

Vendim i Kuvendit nr. 58, datë 19.9.2002	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 37, datë 16.5.2002 “Për krijimin e Komisionit të Integritimit European dhe Paktit të Stabilitetit”, i ndryshuar.....	1630
Vendim i KM nr. 417, datë 29.8.2002	Për shfuqizimin e vendimit nr. 342, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira, me ankand, të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”	1631

VENDIM
Nr. 54, datë 5.9.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E DELEGACIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 29 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Në përbërjen e delegacioneve të përhershme të Kuvendit bëhen këto ndryshime:
1. Zoti Servet Pëllumbi caktohet kryetar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Unionin Ndërparlamentar në vend të deputetit Namik Dokle.
 2. Deputetja Ermelinda Mexi caktohet kryetare e delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Parlamentin Europian në vend të deputetit Arben Malaj, ndërsa deputeti Marko Bello caktohet anëtar i këtij delegacioni në vend të deputetit Spartak Poçi.
 3. Deputeti Et'ehm Ruka caktohet kryetar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së në vend të deputetit Kastriot Islami, ndërsa deputeti Taulant Dedja caktohet anëtar i këtij delegacioni në vend të zotit Ismail Lleshi.
 4. Deputeti Fatmir Xhafa caktohet anëtar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Asamblenë Parlamentare të Bashkimit Ekonomik me Detin e Zi (PABSEC) në vend të deputetit Blendi Klosi.
 5. Deputeti Maço Lakrori caktohet anëtar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Iniciativa e Europës Qendrore (CEI) në vend të deputetit Viktor Doda.
 6. Deputeti Gazmir Bizhga caktohet kryetar i delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Asamblenë Parlamentare të BEP-it në vend të deputetit Spartak Poçi.
 7. Deputetët Namik Dokle dhe Vangjel Dule caktohen anëtarë të delegacionit të përhershëm të Kuvendit në Këshillin e Europës në vend të deputetit Taulant Dedja dhe në vendin vakant të krijuar nga vdekja e deputetit Vasil Melo.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 55, datë 5.9.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të neneve 27 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Në komisionet e përhershme bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Agron Tato caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet në vend të deputetit Blendi Klosi, si dhe anëtar i Komisionit të Përhershëm për Arsimin, Kulturën, Shkencën e Sportet.

2. Deputeti Ilir Zela caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme në vend të deputetit Fatos Nano dhe deputeti Marko Bello caktohet anëtar i këtij Komisioni në vend të deputetit Ilir Meta.

3. Deputetja Ermelinda Meksi caktohet anëtare e Komisionit të Përhershëm për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin në vend të deputetit Arben Malaj.

4. Deputeti Ardit Kaja caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm të Mbrojtjes.

5. Deputeti Fatmir Xhafa caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore dhe i Komisionit të Përhershëm të Mbrojtjes.

6. Deputeti Ndre Legisi caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Rendin dhe SHISH-in në vend të deputetit Spartak Poçi dhe Stefan Çipa caktohet anëtar i këtij Komisioni në vend të deputetit Ben Blushi.

7. Deputeti Et'hem Ruka caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Arsimin, Kulturën, Shkencën e Sportet.

8. Deputeti Maqo Lakrori caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Industrinë, Punët Publike dhe Tregtinë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

**VENDIM
Nr. 56, datë 5.9.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.36, DATË 16.5.2002 «PËR
KRIJIMIN E KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË OSBE-SË/ODIHR-IT PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË
VITIT 2001», I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Përbërja e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 ndryshohet si më poshtë:

1. Deputeti Et'hem Ruka caktohet anëtar i Komisionit në vend të deputetit Blendi Klosi.

2. Deputeti Fatmir Xhafa caktohet anëtar i Komisionit në vend të deputetit Taulant Dedja.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

VENDIM
Nr. 57, datë 5.9.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 37, DATË 16.5.2002 “PËR
KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PAKTIT TË
STABILITETIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e Komisionit të Integrimit Europian dhe Paktit të Stabilitetit ndryshohet si më poshtë:

Deputeti Maqo Lakrori caktohet nënkryetar i Komisionit në vend të deputetit Ilir Zela.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 58, datë 19.9.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 37, DATË 16.5.2002 “PËR
KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PAKTIT TË
STABILITETIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr.37, datë 16.5.2002 “Për krijimin e Komisionit të Integrimit Europian dhe Paktit të Stabilitetit”, i ndryshuar, përbërja e Komisionit të Integrimit Europian dhe Paktit të Stabilitetit ndryshohet si më poshtë:

Deputetët Marko Bello dhe Ardian Myslimi caktohen anëtarë të Komisionit në vend të deputetëve Arben Malaj dhe Ben Blushi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 417, datë 29.8.2002

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.342, DATË 11.7.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DHËNIEN ME QIRA, ME ANKAND, TË OBJEKTEVE TË
NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjet nr.7653, datë 23.12.1992; nr.7723, datë 21.6.1993; nr.7925; datë 19.4.1995; nr.8159, datë 7.11.1996; nr.8333 datë 23.4.1998 dhe nr.8884, datë 22.4.2002 me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 342, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie me qira, me ankand, të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.





KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Kodin Civil (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodi Rrugor dhe ligji për transportet, të azhurnuar);
- Kodin Zgjedhor (të azhurnuar);
- Kodi doganor (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor).



U dorëzua për shtyp më 23.9.2002
Doli nga shtypi më 24.9.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 50 lekë